

L I G J
Nr.8105, datë 28.3.1996

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7973, DATË 26.7.1995 “PËR KONCESIONET DHE
PJESËMARRJEN E SEKTORIT PRIVAT NË SHËRBIMET PUBLIKE DHE
INFRASTRUKTURËN”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Në ligjin nr.7973, datë 26.7.1995, në nenin 9, pika 3 ndryshohet si vijon:

“Për pasuritë kombëtare, si ato të përcaktuara në pikat 2 dhe 4 të nenit 3, marrëveshjet hyjnë në fuqi pasi ratifikohen nga Kuvendi Popullor, me përjashtim kur në ligj është parashikuar ndryshe. Në rastet e tjera marrëveshjet hyjnë në fuqi kur miratohen nga Këshilli i Ministrave.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1451, datë 5.4.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha